



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 20, datë 29.05.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“GODINË BANIMI DHE SHËRBIMI ME 1, 12, 14, 15 DHE 16 KATE MBI TOKË DHE 4 KATE NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues “A & E Development” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimi me 1, 12, 14, 15 dhe 16 kate mbi tokë dhe 4 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “A & E Development” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTORI AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 31/10/2024